



Data: 07.11.2018

Ref.: 1562/18D

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), nenin 50 i Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative (Ligji Nr. 05/L -031 25 maj 2016) KSHC mori:

V E N D I M

Për korrigjimin (përmirësim) e vendimit të KSHC-së Nr.471/18D, datë 18.05.2018

1. Korrigjohet (përmirësohet) vendimi i KSHC-së Nr.471/18D, datë 18.05.2018 i Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" në pikën I dhe II.
2. Korrigjohet (përmirësohet) pika I dhe II, e vendimit të KSHC -së Nr.471/18D, datë 18.05.2018, si në vijim: Përmirësohen të gjitha gradat shkencore të programeve të studimit nga BA, në BSc, dhe nga MA në MSc.
3. Pjesa tjetër e vendimit të KSHC-së Nr.471/18D, datë 18.05.2018, mbetet e pa ndryshuar.
4. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.


Arsyetimi

Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" ka parashtruar kërkesë (nr. 1285/18H, datë 08.10.2018) për përmirësim të vendimit të KSHC-së Nr.471/18D, datë 18.05.2018, në pikën I dhe II. Bazuar në kërkesën e cekur më sipër, dhe nenin 50 të Ligjit mbi procedurën e përgjithshme administrative (Ligji Nr. 05/L -031 25 maj 2016), Agjencia e Kosovës për Akreditim ka trajtuar kërkesën në fjalë, dhe pas kontrollimit në dokumentacionit relevant, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (tash e tutje LPPA) nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti Ekonomik;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

